



## Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

### **Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH**

■ Në kuadër të programit të MKLSH, gjatë muajit qershor është bërë certifikimi i 900 mësimeve të cilët përfunduan me sukses programin e trajnimit. Mësimeve të cilët u certifikuan kanë vijuar trajnimet e MKLSH në 31 qendra të Kosovës si në Prishtinë (4 grupe), në Prizren (3 grupe), në Mitrovicë (2 grupe), në Suharekë (2 grupe), në Gjilan, në Ferizaj, në Gjakovë, në Vushtri, në Skënderaj, në Malishevë, në Istog, në Klinë, në Drenas, në Junik, në Glogjan, në Vitomiricë, në Podujevë, në Krushë të Madhe, në Dragash, në Viti, në Shtime, në Kaçanik, në Kamenicë dhe Hajvali. Trajnimi i 20 grupeve u mundësua nga MASHT, 10 grupe u financuan nga KEC, ndërsa grupin e mësimeve të Istogut e mundësoi bashkëpunimi i DKA së Istogut dhe KEC. Është me rëndësi të ceket se në mesin e të trajnuarve janë dhe 60 mësime të komunitetit boshnjak të komunës së Prizrenit dhe të Pejës.



Me rastin e certifikimit në çdo qendër u organizua një koktej rasti, ku koordinatori falënderonte trajnerët për punën e bërë, pjesëmarrësit për korrektësinë e tyre, si dhe disa zyrtarë të arsimit, të cilët kishin dhënë kontribut në mbarëvajtjen e seminareve. Pas çdo certifikimi ka pasur pyetje nga pjesëmarrësit se kur do të fillojnë trajnimin grupet e reja. Mësimeve të cilët kanë shprehur interesimin e kolegëve të tyre të cilët shprehin interesim të jashtëzakonshëm për të marrë pjesë në trajnim. Në çdo grup është dhënë informacioni se grupet e reja do të fillojnë trajnimin në shtator të vitit 2008.



### **Trajnimi i mësimeve të historisë**

■ Më 14 qershor 2008 në lokalet e Villa Gërmia në Prishtinë është mbajtur trajnimi i mësimeve të historisë. Ky trajnim u realizua nga KEC në bashkëpunim me Qendrën për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE). Pjesëmarrës në trajnim ishin

24 mësimdhënës nga të gjitha qytetet e Kosovës. Në fund të seminarit të gjithë mësimdhënësve iu shpërnda kompleti prej 4 librave.

## Hap pas Hapi

■ Me datat 31 maj dhe 1,2 qershor u mbajtën trajnimi avancues për klasën e parë në Prizren. Në këtë trajnim kishte 29 pjesëmarrës të cilët në fund edhe u certifikuan. Trajnimi u financua nga MASHT dhe ishte trajnimi i fundit i këtij cikli të trajnimeve.

■ Me 6-8 qershor në zyrat e KEC u mbajt trajnimi për klasën e tretë për regionin e Podujevës. Pjesëmarrësit ishin shumë të kënaqur me përmbajtjen e trajnimit dhe u zotuan se të gjitha njohuritë e fituara do të mundohen ti zbatojnë. Në fund të trajnimit u ndanë edhe certifikatat.

Gjithashtu me datën 6-8 qershor në zyrat e KEC u mbajt edhe trajnimi avancues për klasën e parë. Për këtë trajnim u certifikuan 21 pjesëmarrës.

## Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Përfundoi cikli i tretë i trajnimit të 500 mësimdhënësve. Gjatë këtij cikli u mbajtën trajnimet: “Edukimi për drejtësi shoqërore”, “Edukimi për të drejtat e fëmijës” dhe “Avokimi për politika” në këto vende: Prizren, Podujevë, Drenas, Istog, Klinë dhe Kamenicë.

Me këtë edhe përfundoi aktiviteti për trajnimin e 500 mësimdhënësve.



■ Në kuadër të këtij projekti janë mbajtur aktivitete të ndryshme vetëdijesimi, me anë të të cilave është synuar që sadopak të ndikohet në shtimin e pjesëmarrjes në arsim.

■ Më 8 korrik do të mbahet konferenca ndërkombëtare “Shoqëria Civile dhe Pjesëmarrja në Arsim”. Pritet që në këtë konferencë të marrin pjesë rreth 150 pjesëmarrës. Në mesin e pjesëmarrësve do të ketë të ftuar edhe nga Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia, Kroacia, Hungaria dhe Sllovakia.

## Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Gjatë muajit qershor shkollat pjesëmarrëse në ciklin e dytë të PPPA II kanë hartuar projektet shkollore. Gjatë planifikimit dhe hartimit të këtyre projekteve shkollore, shkollat janë ndihmuar nga bashkëpunëtorët profesionalë të terrenit. Java e parë e korrikut do të shërbejë për verifikimin e planifikimeve të bëra. Kjo do të realizohet nga bashkëpunëtorët profesionalë të terrenit në bashkëpunim me ekipet planifikuese të shkollave.

Komponenta e dytë e projektit që ka të bëjë me grantet komunale tashmë është aktive dhe në kuadër të kësaj komponente më 21-

23 qershor 2008 në lokalet e KEC është mbajtur një trajnim për planifikimin e planeve zhvillimore të komunave dhe hartimin e projekteve komunale. Pjesëmarrës në këto trajnime ishin përfaqësuesit e Komiteteve Komunale për Grantin Arsimor (KKGA) nga katër komuna përfituese të granteve komunale: Fushë Kosova, Obiliqi, Prizreni dhe Vushtrria. Gjatë katër javëve të ardhshme komunat do të hartojnë një plan zhvillimor të arsimit në nivel komune.

### **Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim**

■ Sipas planifikimit të aktiviteteve të projektit “Implementimi i Strategjisë së Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian” në Kosovë, gjatë këtij muaji u mbajt edhe një punëtorie njëditore, ku pjesëmarrës ishin të gjithë ata të cilët kanë kontribuar që nga fillimi në hartimin e kësaj kornize. Me këtë punëtori u kompletua kjo Korniza e Monitorimit, e cila pritet që shumë shpejt të publikohet dhe menjëherë të fillohet edhe me monitorimin e parë të kësaj Strategjie.

### **Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**

■ Në përpjekje për të nxitur bashkëpunimin në mes të tri Qendrave, KEC në bashkëpunim me Qendrat ka organizuar një program për fëmijë me rastin e 1 qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijës. Me këtë rast, rreth 20 fëmijë nga Prizreni, Gjakova dhe Dubrava janë takuar në Prizren, në ambientet e Radios Rome. Fillimisht fëmijëve iu është shpjeguar për radion

dhe pajisjet, ndërsa më vonë fëmijët kanë përgatitur një program recital që është transmetuar drejtpërdrejt në radio. Tutje, në Qendrën për Integrimin e Komuniteteve në Prizren fëmijët kanë organizuar një ekspozitë me punimet e tyre. Në fund është organizuar një koktej dhe programi është përmbyllë me shëtitje të fëmijëve në qytet.



■ KEC ka vazhduar monitorimin e punës së organizatave “Durmish Aslano” në Prizren, “Qendra e Komunitetit Ashkali” në Dubravë dhe Bethany Christian Services (BCS) në Gjakovë. Edhe këtë muaj janë organizuar vizita në terren. Kështu, vizita në Prizren dhe Gjakovë është bërë me 19 qershor, ndërsa ajo në Dubravë me 23 qershor 2008. Këto vizita janë bërë për të krijuar një pasqyrë më të qartë dhe për të bërë një bilanc të punës së qendrave me rastin e përfundimit të vitit shkollor.



Ne këtë kontekst janë kontaktuar dhe vizituar edhe disa drejtor të shkollave ku

---

mësojnë fëmijët nga këto komunitete. Në koordinim me shkollat përkatëse, qendrat janë duke punuar në nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave lidhur me performancën në shkollë të fëmijëve të komuniteteve të përfshirë në aktivitetet e qendrave.

■ Aktiviteti i radhës që organizon KEC do të jetë trajnimi treditör “Edukimi për Drejtësinë Shoqërore” që do të mbahet në Prishtinë me 30 qershor, 1 dhe 2 korrik. Në këtë trajnim do të përfshihen 25 mësimdhënës nga shkolla të ndryshme të Prizrenit, Gjakovës dhe Ferizajt ku i vijnë mësimet fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

## **Access Microscholarship Program**

■ Në muajin qershor përfunduan të gjitha aktivitetet e këtij projekti. Edhe grupi nga Prizreni ka përfunduar me mësimin e gjuhës angleze. Për hir të qëndrimit dy vjeçar me grupin, u organizua edhe aktiviteti i fundit social, i shumëpritur nga nxënësit, i cili u mbajt në Prevallë. Në këtë aktivitet morën pjesë të gjitha grupet. Nxënësit patën rastin të takohen edhe një herë me njëri tjetrin me shpresë që edhe në të ardhmen do të kenë programe të ngjashme ku do të mundësoj që këto raporte të mira të krijuara në mes të fëmijëve të komuniteteve të ndryshme të vazhdojnë të zhvillohen edhe më tej.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*